# DËSHMI ARKIVI

**A-461497**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lezhë, Koçiu: Dyfishohen pagesat për fëmijët me aftësi të veçanta, nga tetori do të paguhen kontributet e kujdestarëve |
| ADRESA | `https://tpz.al/lezhe-kociu-dyfishohen-pagesat-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta-nga-tetori-paguhen-kontributet-e-kujdestareve-i333598` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:02:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 11:09:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `361fb0dbeafa2a30003a3ae0ae3913975c3cc6ed14830b957988da01a397dd2b` |
| TEKSTI | `5a4c320c3f550e4805cebe8615336191dcdf1599ea03c222cac04a882e096ae8` |
| PAMJA | `1321a827572b8333619f01328845587fb8e1a85c018410cdd73551521309b222` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ec3b2974371e7750c3d0d9b5d508e42656ea6106de09d33af98aaae02e9db56d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ec3b2974371e7750c3d0d9b5d508e42656ea6106de09d33af98aaae02e9db56d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 22 SEPTEMBER 2026, 13:09

# Lezhë, Koçiu: Dyfishohen pagesat për fëmijët me aftësi të veçanta, nga tetori do të paguhen kontributet e kujdestarëve

tpz.al TPZ



Zëvendëskryeministrja Albana Koçiu ka zhvilluar sot një takim me prindër pranë Qendrës Multifunksionale në Lezhë, ku ka sjellë në vëmendje masat e fundit të qeverisë për mbështetjen e fëmijëve me aftësi ndryshe dhe familjeve të tyre.

Koçiu bëri me dije se nga muaji gusht është dyfishuar pagesa për fëmijët me aftësi ndryshe, si dhe për fëmijët e verbër deri në moshën 18 vjeç. Ndërkohë, nga muaji tetor nis edhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara dhe ndihmësit personalë të tyre.

"Janë rreth 11 mijë fëmijë të cilët do të marrin pagesa të dyfishuara dhe nga fillimi i muajit tetor kemi mbi 14 mijë kujdestarë dhe ndihmës personalë, të cilëve do t'u paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", u shpreh Koçiu.

Zëvendëskryeministrja shtoi se kjo masë do t'u mundësojë kujdestarëve të kenë një pension të sigurt në të ardhmen, ndërsa do të përfitojnë gjithashtu nga skema e sigurimeve shëndetësore, përfshirë mbështetjen në rast të paaftësisë së përkohshme për punë, aksidenteve në punë dhe përfitime të tjera që ofron skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Zëvendëskryeministrja Koçiu theksoi se rritja e pagesave dhe mbështetja e re financiare mundësohen nga buxheti i shtetit, i cili, sipas saj, është rritur si rezultat i rritjes ekonomike.

"Rritja e pagesave patjetër që financohet nga buxheti i shtetit, i cili ka ardhur çdo vit duke u rritur për shkak të rritjes ekonomike. Kjo na garanton që ne të kthejmë vëmendjen dhe të përkushtohemi për të rritur të gjitha ato mbështetje sociale dhe ekonomike për shtresat në nevojë, për personat me aftësi të kufizuara dhe për të gjitha kategoritë në nevojë", tha Koçiu.

Gjatë takimit me prindërit, Koçiu u ndal edhe te zgjerimi i shërbimeve sociale në të gjithë vendin.

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama

“Na vjen shumë mirë që ne mundësojmë, nëpërmjet Fondit Social, mbështetje këtu për stafin, për të pasur më shumë profesionistë në dispozicion për të shërbyer dhe, patjetër, edhe për të përmirësuar akoma më shumë cilësinë e shërbimit që ofrojmë”, u shpreh ajo.

Koçiu tha se numri i shërbimeve sociale është rritur në të 61 bashkitë e vendit. Sipas saj, nga 83 shërbime që ofroheshin rreth një vit e gjysmë më parë, sot janë 98 shërbime sociale që ofrohen në qendra të ndryshme në të gjithë vendin.

Në këto shërbime punojnë mbi 800 profesionistë të fushave të ndryshme, duke u krijuar familjeve mundësi për të vijuar jetën e tyre të përditshme dhe prindërve mundësi për të punuar, ndërsa fëmijët marrin mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e tyre.

Në përfundim, Koçiu theksoi se synimi është ndërtimi i një Shqipërie sociale dhe europiane, ku mundësitë dhe shërbimet të jenë të aksesueshme për të gjithë.

“Qëllimi ynë fundor është Shqipëria europiane, por ne nuk mund të shkojmë dhe të aderojmë në familjen e madhe europiane pa u kujdesur njësoj për të gjithë. Kjo është arsyeja pse edhe Shqipëria sociale, programi më i fundit që kontribuon jo vetëm për shtresat në nevojë apo familjet që kanë kategori vulnerabël, por në çdo aspekt të projekteve dhe programeve që qeveria po ndërmerr, ka në fokus mundësimin dhe ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët në shoqëri”, përfundoi Koçiu.


**tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos**

Shiko të tjera video

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:59

**Hyri për të grabitur në shtëpi, pronari vret shqiptarin, detaje nga jeta e 'dyfishtë' e Lazrit në Torino**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:46

**Masa e SPAK për Vlora Hysenin, Berisha: Nuk ndodh në asnjë vend që shefja e SHISH të jetë në shërbim të krimit! Vizitën e parë pas marrjes së detyrës e bëri në Beograd!**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:35

**Skema/ Lehtësohen faturat e energjisë për klientët debitorë, ulen kamatëvonesat dhe firmosen 300 aktmarrëveshje në rajonin jugor**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:25

**Slloveni/ Ministri i Mbrojtjes, Nufi merr pjesë në Ministerialin e Bashkëpunimit të Mbrojtjes të Evropës Qendrore e Ballkanit Perëndimor**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:15

**VIDEO/ Eurodeputetët në Zvërnec, priten me protesta nga banorët e zonës: Të dëgjohen shqetësimet tona për projektin**

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:03

**Operacion në Fier, Policia Rrugore në 'gjueti' të shoferëve problematikë! Monitoron me dronë dhe radarë parakalimet e gabuara**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:45

**Operacioni i SPAK shkakton debat në Komision, Kaso: Ka rënë shteti! Xhafaj: Arrestimi i zyrtarëve, shenjë e forcimit të shtetit të së drejtës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:26

**Eurodeputetët "zbarkojnë" në Zvërnec, shoqërohen nga ligjvënës të maxhorancës e opozitës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 11:19

**GJKKO caktoi masën "arrest shtëpie" e pezullim nga detyra për Vlora Hysenin, Bardhi: SHISH në duart e krimit të organizuar**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:50

**Arrestimi i drejtoreshës së SHISH-it dhe kontrollet në banesën e Ilir Prodës/ Shehaj: Po bie shteti kriminal i Edi Ramës, të japë dorëheqjen**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:43

**VIDEO/ Panik në det, gomonia pëson avari pranë Porto Palermos, shpëtohen mrekullisht 5 persona**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:36

**Operacioni i SPAK për dosjen 'AKSHI', arrestohet një zyrtar i Policisë dhe një biznesmen! Kontrolle ushtrohen edhe në Durrës**

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:29

## Bordi Transparencës vendos uljen e çmimit të naftës dhe benzinës! Ja me sa do të tregtohen

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:24

## Tabaku reagon pas masave të sigurisë për Vlora Hyseni dhe Prodën: Bie fasada, del sistemi! Presidenti të mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare

AKTUALITET / 22 September 2026, 10:19

## Detaje/ Pas kontrollit në banesë, ish-drejtori i Policisë, Ilir Proda paraqitet në SPAK

AKTUALITET / 22 September 2026, 09:56

## 'Arrest shtëpie'/ GJKKO firmosi masë sigurie me kërkesë të SPAK, ja për çfarë dyshohet drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni

AKTUALITET / 22 September 2026, 09:47

## Bilanci/ Punësimi sezonal jashtë vendit solli një rekord të ri historik prej gati 400 mln euro në janar-qershor!

AKTUALITET / 22 September 2026, 09:40

## Makinës së parkuar i vihet flaka gjatë natës, Policia heton zjarrvënien e qëllimshme, dëshmon pronarja! Sekuestrohen kamerat

AKTUALITET / 22 September 2026, 09:33

## Dyshohet se u hodhën nga pallati e hoteli në Tiranë e

AKTUALITET / 22 September 2026, 09:23

## U cenua siguria kombëtare? SPAK 'arrest shtëpie' e


Kavajë, ndërrojnë jetë dy persona, mes tyre një shtetas belg

pezullim për drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni, rast i paprecedentë në historinë e Shqipërisë

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES NJOFTIME NGA TPZ.AL

tpz.al

AKTUALITET SPORT
IDE TEJ E KETEJ

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.